



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLANJA

QEVERIA E KOSOVËS - GOVERNMENT OF KOSOVO - VLADA KOSOVA

MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE
MINISTRY OF LABOUR AND SOCIAL WELFARE
MINISTARSTVO RADA I SOCIJALNE ZAŠTITE

Në përputhje me nenin 5.1 të Rregullores nr. 2001/19 mbi Degën Ekzekutiv të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë;
Duke pasur parasysh pikën 10 të Udhëzimit Administrativ të MPMS nr. 2001/17 mbi Strukturën dhe funksionimin e Këshillit Konsultativ Trepalësh,
Me qëllim të shtimit të efikasitetit të punës së këtij Këshilli, Ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale nxjerr këtë:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 2007/7 PËR THEMELIMIN DHE
ORGANIZIMIN E SEKRETKARISË TEKNIKE TË KËSHILLIT
KONSULTATIV TREPALËSH**

Neni 1

Me anë të këtij Udhëzimi Administrativ themelohet dhe do të organizohet Sekretaria teknike e Këshillit Konsultativ Trepalësh (KKT), i cili përbëhet nga përfaqësuesit e Qeverisë, Odës Ekonomike të Kosovës (OEK) dhe Bashkimit të Sindikatave të Pavarura (BSPK).

Neni 2

Sekretaria Teknike si organ administrativ i KKT-së do të punoj dhe veproj në kuadër të Zyrës së Sekretarit të Përhershëm të MPMS, dhe për punën e vet do t'i përgjigjet Sekretarit të Përhershëm të kësaj Ministrie.

Neni 3

Detyrat dhe përgjegjësitë e Sekretarisë Teknike të KKT-së janë:

- Përkujdesja për zbatimin e drejtë dhe efikas të Marrëveshjes trepalëshe mbi themelimin e KKT-së në Kosovë,
- Përgatitja e takimeve të KKT-së në përputhje me dispozitat ligjore të aplikueshme,
- Ofrimi dhe sigurimi i asistencës ligjore dhe ndihmës tjetër profesionale për anëtarët e KKT-së,
- Përgatitja dhe përpilimi i procesverbaleve, ekstrakteve të procesverbaleve dhe konkluzioneve nga takimet e KKT-së,
- Inicimi i rekomandimeve të ndryshme për funksionimin e KKT-së si një organ i pavarur pa ndikime politike, gjinore, fetare, etnike, etj.
- Nxitja e konsultimeve parimore dhe konstruktive në mes të partnerëve social, lidhur me punën, mirëqenien sociale dhe politikat ekonomike në Kosovë,
- Raportimi i rregullt për aktivitetet e bëra dhe funksionimin e KKT-së te Sekretari i Përhershëm i MPMS, si dhe
- Detyra dhe përgjegjësi tjera në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore të cilat e rregullojnë dialogun social dhe funksionimin e KKT-së.

Neni 4

Sekretaria Teknike e KKT-së fushëveprimin e vet duhet ta mbështesë në:

- Marrëveshjen Trepalëshe mbi themelimin e KKT-së në Kosovë,
- Udhëzimin Administrativ të MPMS nr. 2001/17 mbi Strukturën dhe funksionimin e KKT-së,
- Rregulloren nr. 2001/27 për Ligjin themelor të punës,
- Kontratën e përgjithshme Kolektive të Kosovës, dhe
- Në legjislacionin tjetër të aplikueshëm nga fusha e punësimit, mirëqenies sociale dhe politikave ekonomike në Kosovë.

Neni 5

Sekretarinë Teknike të KKT-së e përbëjnë katër (4) zyrtar dhe atë:

- Dy (2) zyrtar nga MPMS-ja,
- Një (1) zyrtar nga OEK-u, dhe
- Një(1) zyrtar nga BSPK-ja

Me punën e Sekretarisë Teknike të KKT-së udhëheq koordinatori i Sekretarisë, i cili për punën e vet dhe të Sekretarisë i raporton Sekretarit të Përhershëm të MPMS-së.

Neni 6

Pagat mujore për nëpunësit e Sekretarisë teknike do t'i mbuloj institucioni i cili i delegon këta nëpunës, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore të cilat rregullojnë pagesat e nëpunësve civil të Kosovës.

Neni 7

Për realizimin e punëve të suksesshme të Sekretarisë Teknike të KKT-së, MPMS-ja ka për obligim sigurimin e një zyre të punës me pajisjet e nevojshme, duke përfshirë edhe shpenzimet e telefonisë, internetit dhe të infrastrukturës tjetër publike.

Neni 8

Për zbatimin e këtij Udhëzimi Administrativ është përgjegjës Sekretari i Përhershëm i MPMS-së.

Neni 9

Pjesë përbërëse e këtij Udhëzimi Administrativ janë aktet përkatëse për caktimin e zyrtarëve në Sekretarinë teknike të KKT-së.

Neni 10

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministri i MPMS-së, ndërsa do të aplikohet nga dita e fillimit të punës të Sekretarisë Teknike të KKT-së.

Prishtinë, 22.08.2007

Ministri i MPMS-së
Ibrahim Selmanaj

.....